

DREJT AKSESIT TË BARABARTË

SFIDAT NË PRAKTIKË TË ZBATIMIT TË
NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË BASHKINË
SHKODËR



Funded by
the European Union

IPLS

institute for policy
& legal studies



OPEN SOCIETY FOUNDATION
FOR ALBANIA



Shoqata “Drejtësi Sociale” është një organizatë jofitimprurëse që ka për qëllim promovimin e barazisë, përfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit në shoqëri. Ajo angazhohet në fuqizimin e grupeve të marginalizuara, nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe advokimin për politika publike që garantojnë drejtësi sociale për të gjithë. Përmes aktiviteteve sensibilizuese, projekteve edukative dhe bashkëpunimit me institucione vendore e ndërkombëtare, shoqata synon të ndërtojë një shoqëri më të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Enkelejda Olldashi është profesoreshë e asociuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku ligjëron në fushën e së drejtës publike. Ajo ka përfunduar studimet universitare për drejtësi në Universitetin e Tiranës dhe më pas ka ndjekur studimet master në Studime Europiane, ndërsa doktoraturën në drejtësi e ka mbrojtur në vitin 2008. Me mbi dy dekada përvojë akademike, Olldashi është autore e disa botimeve shkencore në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të drejtave të njeriut. Ajo është angazhuar edhe në projekte të ndryshme kërkimore dhe këshillimore me institucione vendore dhe organizata ndërkombëtare, duke kontribuar në hartimin dhe analizën e politikave publike, reformave ligjore dhe çështjeve që lidhen me drejtësinë sociale dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri.

Mohim përgjegjësie: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit “Judiciary under Spotlight”, një projekt 36-mujor që zbatohet nga konsorciumi i tre partnerëve: Instituti për Studime Politike dhe Ligjore (IPLS), Open Society for Albania (OSFA) dhe Qendra për Fuqizimin Ligjor (CLE). Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit “Civil Society Facility and Media Programme 2021” me referencën IPA III/2022/441-466, si dhe me punën e shoqatës “Drejtësi Sociale” dhe grupit të punës të angazhuar.

Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij raporti i takon tërësisht shoqatës “Drejtësi Sociale” dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet ose politikën e Bashkimit Evropian. Projekti synon zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të strukturuar monitorimi në Gjykatën e Shkodrës për të vlerësuar indikatorin “Aksesi në Drejtësi dhe Gjyqësor i Paanshëm,” me fokus të veçantë tek shërbimet e ndihmës ligjore për grupet e cënueshme. Duke përdorur “Udhëzuesin për Monitorimin e Aksesit në Drejtësi dhe Gjyqësor të Paanshëm – për Organizatat e Shoqërisë Civile,” projekti kryen monitorim analitik të performancës së gjykatës dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësim.

E drejta e autorit © 2025 i përket **Drejtësi Sociale**. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre (elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese ose ndryshe) pa pëlqimin paraprak me shkrim të “Drejtësi Sociale”.



TABELA E PËRMBAJTJES

02

PËRMBLEDHJA

2.1 Përmbledhja	04
2.2 Pyetjet kërkimore	05
2.3 Metodologjia	06
2.4 Hyrje	07

04

VLERËSIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE: ASPEKTE POZITIVE SFIDAT DHE REKOMANDIMET

4.1 Vlerësimi i shërbimit të ndihmës juridike: forca, sfidat dhe rekomandimet	15
4.2 Limitimi i studimit	20

06

REKOMANDIMET

Rekomandime për zbatim	26
Referenca	27

01

HYRJE

1.1 Qëllimi i studimit	4
1.2 Objektivat	4
1.3 Pyetjet kërkimore	5
1.4 Përmbledhja	6
1.5 Metodologjia	7

03

ANALIZA E GJETJEVE

3.1 Analiza e gjetjeve	08
3.2 Burimi i informacionit	10
3.3 Komunikimi me zyrën e ndihmës ligjore falas në Shkodër	11
3.4 Komunikimi me avokatët e caktuar nga shteti	12

05

ANALIZË: FAKTORËT INSTITUCIONALE DHE REKOMANDIME

5.1 Analizë e faktorëve institucionale dhe rekomandime të avancuara	21
5.2 Udhëzues praktik për fazat e ardhshme të implementimit të Kornizës së Monitorimit	25

07

ANEKSE PYETJET E ZHVILLUARA NË INTERVISTËN E STRUKTURARË

7.1 Me përfituesit e shërbimit ligjor falas	28
7.2 Me avokatët që ofrojnë shërbimin	28
7.3 Me zyrën për ofrimin e ndihmës ligjore në Shkodër	28
7.4 Me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas	28



2.1. PËRMBLEDHJE

Ky raport përmbledh procesin dhe rezultatet e projektit “Monitorimi i Shërbimeve të Ndhmës Ligjore në Gjykatën e Shkodrës”, i zbatuar nga shoqata “Drejtësi Sociale” në qytetin e Shkodrës, gjatë periudhës dhjetor 2024 – qeshor 2025. Projekti ka pasur në fokus forcimin e aksesit në drejtësi për grupet në nevojë, përmes ngritjes dhe zbatimit të një sistemi të strukturuar monitorimi mbi shërbimet e ndihmës ligjore.

Për të arritur këtë qëllim, janë ndjekur disa objektiva të qarta, përfshirë ndërtimin e një kornize monitorimi, mbledhjen dhe analizën e të dhënave përmes pyetësorëve, vëzhgimeve, intervistave të strukturuar me avokatë në Gjykatën e Shkodrës, në zyrën e ofrimit të Ndhmës Ligjore Falas, Drejtorinë e ndihmës juridike falas , si dhe përgatitjen e këtij raporti me gjetje dhe rekomandime konkrete për institucionet përkatëse.

Në këtë kuadër, metodologjia e ndjekur ka kombinuar teknika sasiore dhe cilësore, si intervistat me përfituesit e ndihmës ligjore, vëzhgimet në terren dhe analizën e të dhënave të mbledhura përmes regjistrave të brendshëm.

Ky projekt synon të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi për shtresat më në nevojë, duke krijuar një model efektiv dhe të qëndrueshëm për monitorimin e shërbimeve publike ligjore. Ai përfaqëson një themel të fortë për reforma institucionale të mëtejshme dhe nxitje të avokimit të bazuar në prova konkrete. Në këtë kontekst, pyetësi i zhvilluar me përfituesit e ndihmës ligjore falas në qytetin e Shkodrës ka siguruar të dhëna të rëndësishme për përvojën e tyre, duke ndihmuar në evidentimin e sfidave dhe mundësive për përmirësim.

Ky raport do të prezantojë në vazhdim informacionin e përgjithshëm mbi projektin, objektivat dhe rezultatet e arritura, metodologjinë, analizën e të dhënave, gjetjet kryesore, si dhe rekomandimet për përmirësimin e shërbimeve të ndihmës ligjore në Gjykatën e Shkodrës. Në përmbyllje, do të trajtohet impakti i projektit në forcimin e aksesit në drejtësi për grupet në nevojë në nivel lokal.



2.2 PYETJET KËRKIMORE

Pyetjet kërkimore të këtij projekti janë formuluar për të vlerësuar në mënyrë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse efektivitetin dhe aksesueshmërinë e shërbimeve të ndihmës juridike falas. Nëpërmjet këtyre pyetjeve, projekti synon të shqyrtojë mënyrat kryesore përmes të cilave qytetarët informohen dhe aplikojnë për ndihmën juridike, si dhe perceptimin e tyre për cilësinë e shërbimeve të ofruara. Një pjesë e rëndësishme e këtij studimi është identifikimi i barrierave të mundshme që pengojnë qytetarët, përfshirë ato ligjore, institucionale dhe fizike, për të pasur akses në ndihmën juridike. Për më tepër, pyetjet kërkojnë vlerësimin e ndikimit të komunikimit me zyrtarët dhe avokatët e caktuar, dhe ndikimin që ka mungesa e informacionit dhe aksesit në internet për qytetarët e cenueshëm. Përgjigjet që do të merren nga këto pyetje do të mundësojnë një pasqyrë të qartë për të adresuar nevojat dhe për të përmirësuar sistemin e ndihmës juridike falas në nivel kombëtar.

1. Si informohen qytetarët për mundësinë e ndihmës juridike falas dhe cilat janë kanalet kryesore që ata përdorin për të marrë informacionin?
2. Cilat janë perceptimet e përfituesve për cilësinë e komunikimit dhe mbështetjes që ofrohet nga zyrtarët e zyrës së ndihmës juridike?
3. Si e vlerësojnë përfituesit procesin e aplikimit dhe dokumentacionit për shërbimin e ndihmës juridike falas? A ka ndonjë pengesë të mundshme në këtë proces?
4. Çfarë ndikimi ka aksesueshmëria fizike dhe logjistike në mundësinë e përfituesve për të marrë ndihmën juridike falas?
5. Sa efikase janë shërbimet juridike të ofruara nga avokatët e caktuar nga shteti dhe cilat janë sfidat që ata hasin gjatë përfaqësimit të klientëve?
6. Si mund të përmirësohet promovimi dhe shpërndarja e informacionit mbi mundësitë për ndihmë juridike falas, veçanërisht për qytetarët që nuk kanë akses në internet?
7. Çfarë barrierash ligjore dhe institucionale ekzistojnë që pengojnë qytetarët të përfitojnë nga shërbimet e ndihmës juridike falas?



2.3 Metodologjia

Në këtë projekt është zbatuar një qasje kërkimore e kombinuar (mixed methods), e cila përfshin si metoda sasiore, ashtu edhe ato cilësore, për të mundësuar një kuptim të thelluar dhe gjithëpërfshirës të realitetit që lidhet me shërbimin e ndihmës ligjore. Zgjedhja e kësaj metodologjie mbështetet në praktikën më të avancuar të kërkimit social dhe juridik, të cilat theksojnë nevojën për triangulim të të dhënave me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe vlefshmërisë së rezultateve (Creswell & Plano Clark, 2018). Përdorimi paralel i të dhënave sasiore dhe cilësore ndihmon jo vetëm në identifikimin e modeleve të përgjithshme, por edhe në kuptimin e konteksteve të veçanta dhe përvojave personale të përfituesve.

Elementi sasiore u realizua nëpërmjet një pyetësoi të strukturuar me përfitues të ndihmës ligjore, duke synuar të mbledhë të dhëna konkrete mbi përvojën e tyre, aksesin në shërbim, cilësinë e mbështetjes së marrë dhe pengesat kryesore të hasura. Kjo lejon një analizë të standardizuar dhe krahasuese të situatës në terren. Nga ana tjetër, komponenti cilësor u mbështet në vëzhgime të drejtpërdrejta dhe intervistat e strukturura me përfaqësues të zyrës së ndihmës juridike në Shkodër, me avokatët e caktuar për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe me përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike falas. Gjithashtu, analiza e regjistrave të brendshëm dhe e të dhënave administrative të ofruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka mundësuar verifikimin e tendencave, kategorive të përfituesve dhe vëllimit të përgjithshëm të shërbimit të ofruar.

Kjo metodologji e shumëanshme përforcon analizën përmes integritit të të dhënave të natyrave të ndryshme, duke garantuar një interpretim të balancuar dhe të bazuar në evidenca. Duke u mbështetur në këtë qasje, studimi jo vetëm që ofron një pamje të saktë mbi funksionimin e ndihmës ligjore falas në praktikë, por gjithashtu kontribuon në identifikimin e boshllëqeve ekzistuese dhe formulimin e rekomandimeve të mbështetura në të dhëna të verifikuara.



2.4 HYRJE

Ligji Nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë më 14 dhjetor 2017 dhe u botua në Fletoren Zyrtare nr. 255, datë 29.12.2017.

Ai hyri në fuqi më 1 qershor 2018, sipas përcaktimit në dispozitat përfundimtare të ligjit.

Raporti i UNDP-së mbi qasjen në drejtësi në Shqipëri thekson se, pas miratimit të Ligjit Nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”, janë bërë hapa të rëndësishëm përpara në forcimin e kuadrit ligjor. Megjithatë, zbatimi praktik i ligjit ka nxjerrë në pah një sërë sfidash që kërkojnë rishikim dhe përmirësim. Një nga problemet kryesore, që theksohet në raport, lidhet me procedurat burokratike dhe dokumentacionin që shpesh pengojnë qytetarët, sidomos ata nga shtresat vulnerabël, të përfitojnë në kohë nga ndihma juridike.

Zbatimi i këtij ligji deri në momentin e hartimit të këtij studimi nxjerr në pah nevojën e rishikimit të tij me qëllim harmonizimin e proceseve që lidhen me dokumentacionin, financimin e OJF-ve, decentralizimin e verifikimit dhe miratimin e kërkesave për ndihmë juridike falas, si dhe lidhur me garantimin e njëtrajtshmërisë së shërbimit në mbarë vendin. Gjetjet e punës kërkimore theksojnë nevojën e rishikimit të kriterëve për statusin ekonomik në kuadër të përfitimit të ndihmës juridike falas me qëllim përfshirjen e kategorive të tjera të cenueshme. Nevojiten edhe ndërhyrje ligjore për të përmirësuar qasjen dhe kriteret e pranimit, përfshirë njohjen e romëve dhe egjiptianëve si kategori të veçanta me të drejtë përfitimi nga ndihma juridike falas. Një tjetër çështje me rëndësi ka të bëjë me nevojën për trajnim të specializuar për ofruesit e ndihmës juridike, gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë përkatës. Shpesh, ofruesve, përfshirë edhe avokatëve, u mungon ekspertiza në fusha specifike, veçanërisht në trajtimin e çështjeve të ndërlikuara dhe delikate, që përfshijnë individë nga grupe të cenueshme, si viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe fëmijë.



3. ANALIZË E GJETJEVE

3.1. Analiza e të dhënave të pyetësorit

Rezultatet e mbledhura nga pyetësi i strukturuar i realizuar me përfituesit e shërbimeve të ndihmës juridike pranë Gjykatës së Shkodrës ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi përvojën e drejtpërdrejtë të qytetarëve me këtë shërbim dhe evidentojnë disa prirje të rëndësishme, si në aspektin e funksionimit të zyrës, ashtu edhe në perceptimin publik për këtë mekanizëm të aksesit në drejtësi.

Një nga gjetjet më domethënëse është fakti se shumica e përfituesve kanë mësuar për ekzistencën e shërbimeve të ndihmës juridike nëpërmjet burimeve jointitucionale, kryesisht rrjeteve sociale dhe rekomandimeve personale nga individë që kanë përfituar më parë. Ky fakt nënvizon një mungesë të dukshme të promovimit dhe ndërgjegjësimit institucional, duke treguar se struktura përgjegjëse për ofrimin e ndihmës ligjore nuk ka zhvilluar strategji të mjaftueshme komunikimi publik apo fushata informuese sistematike për grupet e synuara, veçanërisht për shtresat në nevojë që përballen me barriera të shumëfishta për të hyrë në sistemin gjyqësor.

Në aspektin e komunikimit me përfaqësuesit e zyrës së ndihmës juridike, përgjigjet e pjesëmarrësve në pyetësor tregojnë një përvojë shumë pozitive në shumicën e rasteve. Përfituesit e përshkruajnë qasjen e stafit si të sjellshme, mbështetëse dhe të qartë në udhëzime, duke krijuar një ndjenjë besimi dhe sigurie për qytetarët në kontaktin e tyre me institucionin. Ky është një tregues inkurajues që sugjeron se, pavarësisht sfidave të tjera, komponenti njerëzor dhe ndërveprimi me përfituesit po funksionon në mënyrë efektive.

Në lidhje me procesin administrativ dhe kërkesat dokumentare, shumica e të anketuarve kanë raportuar se procedura për aplikim ka qenë e thjeshtë dhe e përballueshme, pa pengesa të konsiderueshme burokratike. Kjo përbën një aspekt pozitiv që duhet ruajtur dhe përforcuar, duke qenë se shumë nga përfituesit i përkasin grupeve vulnerabël dhe shpesh përballen me mungesë informacioni, burimesh apo aftësish për të naviguar në procese të ndërlikuara institucionale.




Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht perceptimit të favorshëm për disa komponentë të shërbimit, mungesa e informacionit të strukturuar dhe e mekanizmave proaktivë për identifikimin e nevojave të komuniteteve të cënueshme vazhdon të mbetet një sfidë. Rezultatet e pyetësorit sugjerojnë se ekziston nevoja për një strategji më të qartë informimi, edukimi ligjor dhe orientimi në komunitet, e cila të shkojë përtej komunikimit rastësor apo të bazuar në referenca individuale.

Në përfundim, analiza e të dhënave tregon një potencial pozitiv në cilësinë e shërbimit, por gjithashtu nënvizon qartë nevojën për përmirësime strukturore në nivel komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik, me qëllim që shërbimi i ndihmës juridike të jetë më gjithëpërfshirës, i aksesueshëm dhe efektiv për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për të.



3.2 Burimi i informacionit

Kjo e dhënë tregon mënyrat dhe ndarjen në % të formës më të zakonshme me anë të secilës përfituesit janë informuar për përfitimin e ndihmës ligjore falas.




Nga e marrin përfituesit e ndihmës ligjore falas informacionin?

Kjo e dhënë tregon mënyrat dhe ndarjen në përqindje të formave më të zakonshme përmes të cilave përfituesit janë informuar për mundësinë e përfitimit të ndihmës ligjore falas. 60% e të anketuarve kanë mësuar për shërbimin përmes rrjeteve sociale, duke treguar një përdorim të gjerë të platformave online për shpërndarjen e informacionit. Ndërsa 20% e përfituesve kanë marrë informacion përmes medieve tradicionale, dhe një po aq përqindje, 20%, janë informuar rastësisht, për shembull përmes bisedave të përditshme ose përvojave personale të të tjerëve.

Kjo ndarje tregon se megjithëse rrjetet sociale janë burimi kryesor i informacionit, ka ende një hapësirë të konsiderueshme për përmirësime në mënyrën e shpërndarjes së informacionit përmes kanaleve më formale dhe të drejtpërdrejta, si media ose fushata informuese.



3.3 Komunikimi me zyrën e ndihmës ligjore falas në Shkodër



90%

e të intervistuarëve kanë deklaruar se komunikimi ka qenë “shumë mirë” (shkalla më e lartë e vlerësimit).

Si ka qenë komunikimi me punonjësit e zyrës së ndihmës ligjore në Shkodër?

Kjo e dhënë tregon vlerësimin e përgjithshëm të përfituesve për komunikimin me zyrën e ndihmës ligjore falas në Shkodër. Shumica e intervistuarve, 90%, kanë vlerësuar komunikimin si “shumë të mirë”, që tregon një nivel të lartë të kënaqësisë dhe profesionalizmit nga ana e stafit të zyrës. Një pjesë e vogël, 10%, e kanë konsideruar komunikimin si “të mirë”, që gjithashtu sugjeron një përvojë pozitive, megjithatë, me disa mundësi për përmirësim të mëtejshëm.

Megjithatë, problemi kryesor që është identifikuar lidhet me aksesueshmërinë e shërbimeve, pasi përfituesit e kanë pasur të vështirë të arrijnë në zyrën e ndihmës ligjore për shkak të barrierave fizike apo logjistike. Sipas tyre, shërbimi është ofruar dhe marrë përmes një qasjeje më personale, ku punonjësit e zyrës kanë ofruar ndihmë jashtë ambienteve të zyrës, duke shkuar direkt tek individët për të ofruar shërbimin. Kjo tregon një gatishmëri të stafit për të shkuar përtej orarit dhe vendit të zakonshëm të punës për të siguruar që ndihma të jetë e aksesueshme për ata që kanë nevojë.



E DHËNA E TRETË

3.4 Komunikimi me avokatët e caktuar nga shteti



80%

e të intervistuarëve kanë deklaruar se komunikimi me avokatët e caktuar ka qenë “shumë mirë” ose “mirë” (shkalla më e lartë e vlerësimit).

Si ka qenë komunikimi me avokatët e caktuar nga shteti?

Nga të intervistuarit, 80% kanë deklaruar se komunikimi me avokatët e caktuar nga shteti ka qenë “shumë mirë” ose “mirë”, duke treguar një perceptim pozitiv dhe një nivel të kënaqshëm të ndërveprimit me këta profesionistë. Kjo përqindje reflekton besimin dhe mirëkuptimin që përfituesit kanë pasur gjatë bashkëpunimit me avokatët, duke nënvizuar rëndësinë e një komunikimi efektiv dhe të qartë për sigurimin e një ndihme juridike cilësore dhe të besueshme për qytetarët.



Përmes intervistave me përfituesit e shërbimeve të ndihmës juridike falas, u bë e qartë se shumica e qytetarëve që kanë përfituar nga këto shërbime janë informuar kryesisht përmes rrjeteve sociale dhe përvojave personale të të tjerëve. Kjo tregon se, ndonëse përdorimi i mediave sociale është një mjet i fuqishëm për shpërndarjen e informacionit, promovimi institucional i shërbimeve të ndihmës juridike është ende shumë i kufizuar dhe nuk arrin të mbuloni audienca më të gjerë dhe më të cenueshme. Ky informacion i shpërndarë kryesisht përmes rrjeteve sociale dhe gojë më gojë e bën të paqartë shpërndarjen e mundësive për të gjithë ata që mund të kenë nevojë për shërbim, por që nuk janë të lidhur me këto kanale të komunikimit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që u theksua në intervista ishte komunikimi me zyrtarët e zyrës së ndihmës juridike, i cili ka qenë përgjithësisht pozitiv dhe i mirëpritur nga shumica e përfituesve. Shumica e të intervistuarve shprehën një vlerësim të lartë për trajtimin dhe sjelljen e zyrtarëve, që sugjeron se ofruesit e shërbimit kanë ndjekur një politikë mbështetëse dhe të respektueshme ndaj qytetarëve. Ky komunikim është konsideruar si një nga pikat më të forta të shërbimit të ndihmës juridike, pasi përfituesit theksuan se kanë ndjerë mbështetje dhe këshilla të vlefshme, pa hasur vështirësi në komunikim.

Një tjetër pikë e rëndësishme që u ngrit ishte procesi i dokumentacionit për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike. Ky proces është perceptuar si i thjeshtë dhe pa vështirësi për pjesën më të madhe të përfituesve, duke sugjeruar se ndihma juridike e ofruar është e organizuar në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Shumica e përfituesve nuk janë ndjerë të ngarkuar nga dokumentacioni apo procedurat burokratike, dhe kanë shprehur mirënjohje për thjeshtësinë e këtyre proceseve. Kjo është një aspekt pozitiv që mund të nxisë dhe më shumë qytetarë të kërkojnë ndihmën që u nevojitet pa frikë se do të hasin vështirësi të panevojshme administrative.



Individët që i përkasin pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, për shkak të kompleksitetit të problematikave të tyre – si banimi në zona të ndryshme nga vendbanimi formal, mungesa e aksesit në portalin e e-Albania, etj. – shpesh e kanë të pamundur të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për të përfituar ndihmën juridike dytësore. Kjo situatë tregon nevojën për mekanizma më fleksibël dhe për mbështetje aktive nga zyrat e ndihmës juridike, që të mund të përfshihen më lehtë në shërbim dhe të garantohet mbrojtja e të drejtave të tyre.

Përkundër këtyre pikave pozitive, disa përfitues të intervistuar shprehën shqetësime në lidhje me aksesueshmërinë fizike të zyrave të ndihmës juridike dhe se, në disa raste, ata nuk ishin në gjendje të vizitonin zyrën personalisht për shkak të kufizimeve gjeografike ose mungesës së transportit. Ky është një faktor që duhet të merren parasysh për të siguruar që ndihma juridike të jetë e disponueshme për të gjithë, duke përfshirë ata që janë më të cenueshëm dhe që mund të kenë vështirësi të lëvizin.

Në përfundim, analiza e intervistave sugjeron se, ndërkohë që shërbimi i ndihmës juridike falas ofron një nivel të mirë të komunikimit dhe lehtësira për përfituesit, ka ende hapësirë për përmirësim, veçanërisht në fushën e promovimit institucional të shërbimeve dhe aksesueshmërisë fizike për qytetarët. Përmirësimi i këtyre aspekteve mund të çojë në një nivele më të larta të përfshirjes dhe një akses më të gjerë për shërbimet juridike falas, duke garantuar që më shumë qytetarë, veçanërisht ata që jetojnë në kushte të vështira, të mund të përfitojnë nga këto mundësi ligjore.



4. Vlerësimi i shërbimit të ndihmës juridike: aspekte pozitive, sfidat dhe rekomandimet

- **Aksesi në shërbim**

Zyrat e ndihmës juridike falas në Shkodër janë të vendosura në pika qendrore dhe të njohura për publikun, gjë që lehtëson aksesin për shumë qytetarë. Megjithatë, për personat në nevojë dhe grupet më të marginalizuara – si Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK), banorët e zonave rurale dhe emigrantët – aksesueshmëria fizike dhe mundësia për të përfituar shërbimet mbeten problem real. Pamundësia për të siguruar dokumentacionin e kërkuar shpesh pengon përfitimin e ndihmës ligjore, sidomos për pakicat kombëtare romë dhe egjiptiane, të cilat nuk janë gjithmonë të kategorizuara si përfitues të veçantë. Përfituesit raportojnë se shpesh ndihmohen nga punonjësit përmes ofrimit të shërbimeve jashtë zyrës, duke treguar përkushtimin e stafit, por edhe mungesën e mekanizmave të strukturuar për të arritur këto grupe. Mungesa e një rrjeti paraligjor aktiv dhe barrierat burokratike reduktojnë kapacitetin e sistemit për të ofruar mbështetje efektive dhe gjithëpërfshirëse, duke reflektuar problemet më të gjera të aksesit në ndihmën juridike falas në Shqipëri.

Rekomandim: Rekomandohet që në kuadër të sistemit të ndihmës juridike falas, pakicat kombëtare romë dhe egjiptiane, si dhe emigrantët e huaj, të njihen si kategori e veçantë përfituesish në ligj. Kjo njohje do të sigurojë qasje të drejtpërdrejtë dhe të barabartë në shërbimet juridike, duke adresuar pengesat specifike që këto grupe përballen, përfshirë barrierat burokratike, mungesën e dokumentacionit dhe aksesin fizik të kufizuar. Një mekanizëm i tillë do të forcojë mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe do të lehtësojë përfshirjen aktive në proceset ligjore dhe shoqërore.



- Efikasiteti procedural

Përfituesit e ndihmës juridike e kanë përshkruar procesin e aplikimit si të thjeshtë dhe të kuptueshëm, ndërsa koha mesatare për trajtimin e kërkesave është perceptuar si e pranueshme. Megjithatë, në nivel gjyqësor, vonesat që lidhen me shtyrjen e seancave dhe ngarkesën e lartë të gjyqtarëve ndikojnë në zvarritjen e proceseve. Këto vonesa, për qytetarët në kushte të vështira, përfaqësojnë një barrë jo vetëm ligjore, por edhe sociale dhe emocionale. Sistemi aktual nuk garanton një menaxhim të qëndrueshëm të çështjeve që lidhen me ndihmën juridike falas, sidomos në rastet kur duhen ndjekur me përparësi.

Rekomandim: Rekomandohet prioritizimi i çështjeve me karakter familjar nga gjyqtarët, duke siguruar që këto raste të trajtohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë. Po ashtu, sugjerohet përfshirja e asistentëve gjyqësorë dhe përmirësimi i mekanizmave të brendshëm të menaxhimit të çështjeve, në mënyrë që proceset të jenë më efikase, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt mbrojtjes së interesave të palëve vulnerabël.



- Mbështetja financiare

Ndihma juridike falas gëzon mbështetje nga partnerë ndërkombëtarë si OSBE, të cilët kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat ligjore. Megjithatë, sfida kryesore mbetet buxheti shtetëror i pamjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet praktike të qytetarëve, si transporti për në gjykatë apo dokumentacioni shtesë. Për shumë individë që jetojnë në varfëri ose në zona të izoluara, këto kosto minimale janë barriera reale për të përfituar nga shërbimi që, në teori, është falas.

Rekomandohet rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) për financimin e ndihmës juridike dhe sigurimi i një buxheti të dedikuar për mbulimin e kostove logjistike të përfituesve.

- Referimet dhe bashkëpunimi

Në praktikë, një nga aspektet më funksionale të sistemit është ekzistenca e një rrjeti të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë si pika referimi për qytetarët në nevojë për ndihmë juridike. Këto organizata kanë ndihmuar në orientimin dhe mbështetjen e përfituesve, duke përmirësuar aksesin në shërbime. Megjithatë, bashkëpunimi nuk është gjithmonë i formalizuar dhe mungesa e strukturës së rrjetit të paraligjorëve bën që referimet të mos jenë gjithmonë të shpejta ose të koordinuara. Kjo ndikon në efikasitetin dhe vazhdimësinë e ofrimit të ndihmës.

Rekomandim: Formalizimi i bashkëpunimit ndërmjet zyrave të ndihmës juridike, OJQ-ve dhe paraligjorëve, si dhe zgjerimi i pranisë së tyre në terren për të mbuluar më mirë zonat periferike dhe rurale.




Analizë plotësuese mbi përfituesit e ndihmës juridike dytësore (Në vijimësi të takimit informues të datës 19.03.2025 në QSHNJP Shkodër)

Në kuadër të procesit të monitorimit të aksesit në ndihmë juridike, takimi informues i zhvilluar më 19 mars 2025 në ambientet e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP) në Shkodër ofroi një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të kërkesave për ndihmë juridike dytësore falas dhe karakteristikat e përfituesve.

Të dhënat e paraqitura tregojnë një ulje të qëndrueshme të numrit të kërkesave për ndihmë juridike dytësore gjatë tri viteve të fundit: nga 58 kërkesa në vitin 2023, në 48 në vitin 2024, dhe vetëm 6 kërkesa të regjistruara deri në mars të vitit 2025. Kjo tendencë rënëse kërkon analizë të kujdesshme për të identifikuar shkaqet që mund të ndikojnë në këtë reduktim të ndjeshëm të kërkesave.

Numri i çështjeve të paraqitura përgjatë viteve



Mes faktorëve potencialë që mund të ndikojnë në këtë fenomen përmenden mungesa e informimit të gjerë publik, pengesat administrative gjatë procesit të aplikimit, si dhe niveli ende i pamjaftueshëm i promovimit institucional të shërbimit, veçanërisht në zonat rurale apo për grupet vulnerabël që më së shumti kanë nevojë për këtë lloj mbështetjeje.

Këto të dhëna sugjerojnë nevojën për rishikimin e strategjive të informimit dhe ndërgjegjësimi, forcimin e kapaciteteve institucionale për përpunimin e kërkesave, si dhe përfshirjen më të madhe të strukturave komunitare (si paraligjorët apo OJF-të) në identifikimin dhe orientimin e individëve që kanë të drejtë për ndihmë juridike dytësore.



- **Financimi dhe logjistika e pamjaftueshme**

Rimbursimi i shpenzimeve të transportit sipas VKM-së aktuale është tepër i ulët dhe nuk reflekton realitetin e kostove për qytetarët dhe avokatët në terren. Në raste të veçanta, vetëm mbështetja e donatorëve, si OSBE, ka mundësuar mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke treguar nevojën urgjente për përditësimin e mekanizmave të rimbursimit dhe sigurimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe realist për shërbimet e ndihmës juridike falas.

- **Mungesa e promovimit institucional dhe strukturave ndihmëse**

Informimi për shërbimet e ndihmës juridike kryhet në mënyrë të fragmentuar, përmes posterave në gjykata, rrjeteve të OJF-ve apo iniciativave individuale të zyrave. Mungesa e një rregullimi ligjor për rolin e paraligjorëve kufizon mundësinë e tyre për të ndihmuar në orientimin dhe informimin fillestar të qytetarëve, duke lënë boshllëqe në qasjen ndaj informacionit dhe në përfshirjen e grupeve më vulnerabël.

- **Apelimet institucionale të vendimeve gjyqësore për raste vulnerabël**

Shpeshherë, institucionet ankimojnë vendimet e gjykatave për qëllime statistikore, duke i përdorur proceset e apelit për të rritur numrin e rasteve të regjistruara ose për të përmirësuar tregues të brendshëm administrativë. Ky praktikum, megjithatë, ka pasoja të drejtpërdrejta për qytetarët që kërkojnë ndihmë juridike, pasi vonon dhënien e vendimeve përfundimtare dhe pengon zbatimin e të drejtave të tyre në kohë. Përfituesit, të cilët shpesh ndodhen në kushte të vështira sociale, ekonomike ose familjare, përballen me pasiguri dhe stres shtesë, duke u privuar nga mbrojtja dhe shërbimi për të cilin kanë aplikuar. Kjo situatë tregon nevojën për rishikim të praktikave ankimore dhe për vendosjen e mekanizmave që të sigurojnë se çështjet me karakter social ose familjar trajtohen me prioritet, në mënyrë që të minimizohet dëmi për qytetarët më vulnerabël.



4.2 Limitimi i studimit:

- Ky studim është i kufizuar vetëm në qytetin e Shkodrës dhe fokusohet në periudhën 2021-2024, duke mos përfshirë qytete të tjera ose periudha më të gjera kohore.
- Nga gjithsej 300 përfitues të shërbimeve të ndihmës juridike falas në këtë qytet, vetëm 60 persona kanë pranuar të marrin pjesë dhe të përgjigjen në pyetësor, duke përfaqësuar rreth një pjesë të vogël të totalit të përfituesve. Ky nivel pjesëmarrjeje kufizon përgjithësueshmërinë e gjetjeve dhe mund të mos pasqyrojë plotësisht përvojat e të gjithë përdoruesve të shërbimit.
- Për më tepër, përqendrimi vetëm në Shkodër mund të mos reflektojë sfidat dhe praktikat në qytetet e tjera të Shqipërisë, ndërsa një numër i vogël i të anketuarve mund të ndikojë në diversitetin e perspektivave dhe të nënvlerësojë disa problematika specifike që përballen grupet vulnerabël. Këto kufizime duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve dhe rekomandimeve të studimit.



5. ANALIZË E FAKTORËVE INSTITUCIONALE DHE REKOMANDIME TË AVANCUARA

Faktorët institucionalë që ndikojnë në funksionimin e ndihmës juridike falas, ndër të tjera janë, edhe mbingarkesa e gjyqtarëve dhe vonesat procedurale, problematikat e aksesit fizik dhe infrastrukturor, procedurat e ndërlikuara, financimi, mungesa e promovimit institucional dhe strukturave ndihmëse, apelimet institucionale të vendimeve gjyqësore për raste vulnerabël.

Bazuar në intervistat e zhvilluara me avokatë të përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike falas, si dhe me përfaqësues të zyrave publike në Shkodër dhe Tiranë, identifikohen këto faktorë institucionalë kyç:

- Mbingarkesa e gjyqtarëve dhe vonesat procedurale

Mbingarkesa me mbi 400 çështje për gjyqtar është raportuar si një problematikë e përhapur, ndërkohë që shtyrjet e panevojshme të seancave ndikojnë negativisht në efikasitetin dhe besimin e përfituesve.

- Problematikat e aksesit fizik dhe infrastrukturë

Në Shkodër, ambientet e zyrës së ndihmës juridike falas janë të vogla dhe me akses të kufizuar për persona me aftësi të kufizuar; punonjësit shpesh detyrohen të dalin jashtë për të ofruar ndihmë për PAK, çka tregon për mungesë të standardeve minimale të aksesit.

- Procedura të ndërlikuara për përfitim

Dokumentacioni kërkohet në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme, duke përjashtuar raste që objektivisht nuk mund të përmbushin kërkesat burokratike. Në praktikë, mungon një qasje lehtësuese, sidomos për rastet penale, ku shpesh ndihma nuk jepet për shkak të pamundësisë për të dorëzuar dokumentacionin.



Rekomandime të avancuara për përmirësimin e shërbimit

Bazuar në gjetjet cilësore dhe sasore të projektit, rekomandohen ndërhyrjet e mëposhtme:

- **Përmirësim i aksesit**

Rekomandohet të lehtësohet aksesimi i qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike përmes forcimit të rolit të paraligjorëve, duke shërbyer si ura lidhëse midis komuniteteve dhe institucioneve. Njëkohësisht, është e rëndësishme të kategorizohen si grup përfitues i veçantë individët që i përkasin pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane, si dhe emigrantët, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së barabartë të të drejtave të tyre. Po ashtu, sugjerohet transferimi i zyrave të ndihmës juridike në ambiente të përshtatshme dhe të përputhshme me standardet e aksesit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), duke garantuar që shërbimi të jetë gjithëpërfshirës dhe pa barriera.

- **Rishikim i kuadrit financiar:**

Rekomandohet përditësimi i VKM-së për rimbursimin e transportit, duke e lidhur atë me distancat reale dhe duke marrë parasysh kontekstin gjeografik të zonave, në mënyrë që të sigurohet një mbulim më i drejtë dhe efektiv i kostove të udhëtimit për qytetarët. Gjithashtu, propozohet krijimi i një fondi të veçantë për mbulimin e shpenzimeve të rasteve emergjente ose me ndjeshmëri të lartë sociale, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për individët dhe familjet në nevojë.

- **Lehtësim procedurash dhe fleksibilitet në verifikim:**

Rekomandohet hartimi i udhëzuesve të thjeshtuar dhe të qartë mbi dokumentacionin e nevojshëm, të ndarë sipas kategorive përfituese, në mënyrë që qytetarët të kenë informacion të aksesueshëm dhe praktik. Po ashtu, sugjerohet aplikimi i deklaratës nën betim si provë paraprake në rastet kur dokumentacioni mungon.



- **Ndërprerja e praktikës së apelimit për arsye jothelbësore**

Rekomandohet nënshkrimi i një memorandumit ndërinstitucional midis Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me synim priorizimin e shqyrtimit të çështjeve me karakter familjar në nivelin e Apelit. Një nismë e tillë do të kontribuonte në shmangien e problemeve sociale që rëndojnë kryesisht mbi gratë dhe fëmijët, të cilët preken drejtpërdrejt nga vonesat në dhënien e drejtësisë, duke qenë se vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk marrin formë të prerë për shkak të ankimeve nga ish-bashkëshortët.

- **Strategji kombëtare komunikimi:**

Rekomandohet zhvillimi i fushatave të qëndrueshme informuese për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, duke shfrytëzuar si mediat tradicionale, ashtu edhe rrjetet sociale për një shtrirje më të gjerë të qytetarët.

- **Kornizë Monitorimi për Shërbimet e Ndhmës Juridike Falas**

Rekomandohet ngritja e një Kornize Monitorimi që do të garantojë vlerësimin periodik të cilësisë, aksesueshmërisë, efikasitetit dhe ndikimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në Shqipëri. Kjo kornizë do të shërbejë si mekanizëm i qëndrueshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit, duke siguruar që shërbimi të jetë i drejtë, gjithëpërfshirës dhe funksional. Objektivat kryesore të saj përfshijnë: matjen e aksesit në shërbim për grupet vulnerabël; vlerësimin e cilësisë së përfaqësimit ligjor; verifikimin e respektimit të procedurave ligjore dhe etike; monitorimin e efikasitetit kohor dhe logjistik; si dhe identifikimin e boshllëqeve institucionale dhe financiare. Korniza do të mbështetet në tregues të matshëm (KPI), të mbledhur përmes regjistrave zyrtarë, pyetësorëve, intervistave dhe sondazheve, duke u raportuar në intervale tremujore, gjashtëmujore ose vjetore, sipas fushës së matjes.



5.2. Udhëzues praktik për fazat e ardhshme të implementimit të Kornizës së Monitorimit

Instrumentet/ Metodologjia	Veprimet e Sugjeruara në Vijim	Aktorët Përgjegjës
Formularë vlerësimi për përfituesit	Hartimi i formularëve të unifikuar dhe testimi pilot në disa zyra	Zyra e Ndihmës Juridike Falas + OJF partnere
Intervista me avokatë dhe staf mbështetës	Organizimi i cikleve tremujore intervistash për të vlerësuar cilësinë e përfaqësimit	Dhoma e Avokatisë + OJF partnere
Sistemi i mbledhjes së të dhënave (Excel/online)	Krijimi i një platforme online për regjistrim dhe analizë të të dhënave në kohë reale	Zyra e Ndihmës Juridike + Ministria e Drejtësisë + mbështetje nga donatorët
Vizita vëzhguese në zyra/gjykata	Hartimi i një kalendarit vjetor për vizita monitoruese në nivel vendor	OJF partnere + Ministria e Drejtësisë



6. Rekomandime për Zbatimin

Për të garantuar një zbatim efektiv dhe të qëndrueshëm të monitorimit të ndihmës juridike falas, si dhe për të rritur ndikimin e tij në përmirësimin e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël, rekomandohen këto masa konkrete:

- *Krijimi i një Komiteti Kombëtar Monitorimi, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve shtetërore përkatëse, shoqërisë civile, avokatisë dhe institucioneve akademike. Ky komitet do të ketë funksionin të koordinojë procesin e monitorimit, të sigurojë transparencë dhe të ndjekë zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet.*
- *Hartimi i një Raporti Kombëtar Vjetor, i cili të mbledhë dhe analizojë të dhënat e monitorimit nga të gjitha zyrat e ndihmës juridike në vend. Raporti duhet të përfshijë vlerësime të pavarura, statistika, histori suksesi dhe analiza mbi sfidat kryesore, si dhe të paraqesë rekomandime konkrete për përmirësim institucional dhe ligjor.*
- *Integrimi i kornizës së monitorimit në strategjitë kombëtare për drejtësinë, barazinë sociale dhe përfshirjen e grupeve vulnerabël. Kjo do të sigurojë që monitorimi i aksesit në drejtësi të mos mbetet një nismë e izoluar, por të bëhet pjesë përbërëse e politikave të zhvillimit social dhe ligjor në vend.*
- *Përdorimi i të dhënave të mbledhura për avokim të bazuar në prova, duke nxitur ndryshime në politikat publike, legjislacion dhe praktikë administrative. Të dhënat duhet të përdoren nga aktorët e shoqërisë civile dhe institucionet për të ngritur çështje prioritare në agjendën publike dhe për të siguruar një përgjegjshmëri më të lartë institucionale.*

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të forcojë sistemin e ndihmës juridike falas në Shqipëri dhe do të kontribuojë në një sistem drejtësie më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.



Referenca

1. Legjislacioni dhe dokumentet zyrtare

- Ligji nr. 10039, datë 23.12.2008, “Për ndihmën juridike falas” (i ndryshuar më pas).
- VKM për rimbursimin e shpenzimeve të transportit për shërbimet e ndihmës juridike.
- Udhëzime administrative të Ministrisë së Drejtësisë për funksionimin e zyrave të ndihmës juridike.

2. Nga studime dhe raporte

- UNDP Albania. Study on Access to Justice in Albania. Tirana: UNDP, 2025, 12–13



7. ANKESE

7.1. Pyetjet e zhvilluara në intervistën e strukturara me përfituesit e shërbimit ligjor falas

- Si e keni marrë vesh për ekzistencën e këtij shërbimi?
- Si ka qenë komunikimi me punojnësin e zyrës së shërbimit?
- Sa ka zgjatur çështja juaj?
- Sa të vështirë e keni pasur për grumbullimin e dokumenteve?
- Si ka qenë komunikimi me avokatet dhe si do e vlerësonit shërbimin e tyre?
- Si do e vlerësonit shërbimin e prej fillimit deri në fund nëse do përdorim nota shkolle (1-10)?

7.2. Pyetjet e zhvilluara në intervistën e strukturara me avokatët që ofrojnë shërbimin

- Si përcaktohen çështjet që dë të ndiqen dhe si përcaktohen avokatët që ofrojnë shërbimin?
- Cilat janë rastet më të shpeshta të trajtuara (civile, administrative, penale)?
- Si bëhet rimbursimi i transportit për ofrimin e shërbimit?
- Cilat janë problematikat më të mëdha në ofrimin e procesit?

7.3. Pyetjet e zhvilluara në intervistën e strukturara me zyrën për ofrimin e ndihmës ligjore në Shkodër

- Si organizohet ofrimi i shërbimit për qytetarët në zonat qendrore dhe rurale?
- Cilat janë sfidat kryesore të stafit në ofrimin e shërbimit?
- Si monitorohet dhe vlerësohet puna e stafit dhe e avokatëve?
- A ka mekanizma për ndihmën e qytetarëve që nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e kërkuar?
- Si përfshihen grupet vulnerabël dhe komunitetet e marginalizuara në shërbim?

4. Pyetjet e zhvilluara në intervistën e strukturara me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas

- Si koordinohet puna me zyrat lokale (p.sh. Shkodër) dhe me avokatët në terren?
- Cilat janë mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit?
- Si bëhet ndarja e rasteve dhe çështjeve prioritare?
- Si menaxhohen ankesa ose vonesa në shërbim?
- Çfarë përmirësimesh janë të nevojshme për rritjen e efikasitetit dhe aksesueshmërisë së shërbimit?



SHTATOR 2025